



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.738/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “S... – CO” sh.p.k., me seli në fshatin, Magjistratja Suharekë-Prizren, kundër debitorit Komuna e Malishevës, Drejtoria e Urbanizmit, duke vendosur sipas parashtrësës së kreditorit për tërheqjen e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 339/21, të datës 24.08.2021, të Përmbartuesit Privat Saranda Kuçi, me seli në Prizren, jashtë seancës me datën 08.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura e përmbartimit e lejuar sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr. 339/21, të datës 24.08.2021, të Përmbartuesit Privat Saranda Kuçi me seli në Prizren, në çështjen përmbartimore të kreditorit “S... – CO” sh.p.k., me seli në fshatin, Magjistratja Suharekë-Prizren, kundër debitorit Komuna e Malishevës, Drejtoria e Urbanizmit, për shkak të tërheqjes së propozimit nga ana e kreditorit.

A r s y e t i m

Përmbartuesit Privat Saranda Kuçi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “S... – CO” sh.p.k., ka caktuar urdhrin P.nr. 339/21, të datës 24.08.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës nr. 5 të datës 05.07.2021 dhe Faturës nr.6 të datës 05.07.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin Komuna e Malishevës, Drejtoria e Urbanizmit, që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave së lartcekura, të paguaj shumën prej 77,875.20 € (shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë euro e njëzet cent) me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, në të kundërtën të bllokohen llogaritë bankare të debitorit në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe të barten mjetet nga llogaria e debitorit në llogarinë e kreditorit, të bëhet regjistrimi, sekuestrimi dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe paluajtshme deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimit ndaj kreditorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit me datë 31.08.2021, prapësim ka paraqitur debitori Komuna e Malishevës, Drejtoria e Urbanizimit, përmes Avokatit Publik të Komunës Mujë Sahitaj, si dhe përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori “S.... – CO” sh.p.k., me seli në fshatin, Magjistralja Suharekë-Prizren.

Kreditore “S.... – CO” sh.p.k., me anë të parashtresës së datës 17.08.2022, e ka njoftuar gjykatën se tërhiqet nga Urdhri Përmbarimor P.nr. 339/21, i datës 24.08.2021, për faktin se debitori Komuna e Malishevës, i ka përbushur obligimet në emër të debitorit dhe se nuk kanë interes që të vazhdojnë më tutje me procedurat, si dhe shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 42 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore i cili përcakton se “ *Propozimi për përmbarim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditore gjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore pa pëlqimin e debitorit*” dhe par. 2 të po këtij neni i cili përcakton se “ *Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbarim organi përmbarues e përfundon përmbarimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht* “, dhe duke vendosur sipas parashtresës së kreditorit këtë çështje përmbarimore e përfundoi në tërësi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 42 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.738/22, datë 08.09.2022

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.